



Rr. "Abdi Toptani", ish Hotel Drini



info@kmshc.al



www.kmshc.al

29 Prill 2025

NJOFTIM

PËR TAKIMIN E ZHVILLUAR ME PËRFAQËSUES TË OSBE/ODHIR, NË ROLIN E VËZHguesve AFATGJATË, TË ATASHUAR NË QARKUN E GJIROKASTRËS

Në kuadër të monitorimit të sjelljes së nëpunësve civilë gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet parlamentare 2025, Grupi i Punës i ngarkuar me këtë detyrë në Qarkun e Gjirokastrës, më datë 29 prill 2025, u takua me përfaqësuesit e OSBE/ODIHR Znj. Tarja Raappana dhe Z. Vincent Godbillon, në cilësinë e vëzhguesve afatgjatë të zgjedhjeve në ambientet e Bashkisë Dropull. Takimi u fokusua në ndarjen e informacionit mbi kompetencat e institucionit të Komisionerit, rolin e tij në këtë proces dhe metodologjinë e ndjekur për garantimin e zbatimit të parimit të paanësisë politike në administratën publike përgjatë fushatës zgjedhore.

Konkretisht, gjatë bashkëbisedimit, u prezantuan aspektet kyçe të procesit të mbikëqyrjes, përfshirë funksionimin e grupeve të monitorimit, raportimin ditor të institucioneve, rastet e rekrutimeve apo shkeljeve disiplinore në shërbimin civil, si dhe ndërveprimi me KQZ-në dhe aktorë të tjerë zgjedhorë. Vëzhguesit u informuan gjithashtu mbi udhëzimet e nxjerra nga Komisioneri dhe praktikën e ndjekura prej tij që synojnë të standardizojnë sjelljen e nëpunësve civilë gjatë periudhave elektorale, përfshirë edhe aspektet që lidhen me shprehjen e bindjeve politike në rrjete sociale. Në fund të takimit, përfaqësuesit e OSBE/ODIHR falënderuan institucionin për transparencën dhe angazhimin në mbështetje të standardeve ndërkombëtare për administrimin e procesit zgjedhor.

